



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTVENDIM

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017 “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Damian Gjikhuri caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Deputeti Arben Pëllumbi largohet nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

III. Deputetja Mirela Kumbaro caktohet anëtare në Komisionin për Integrimin European dhe në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

IV. Deputetët Senida Mesi dhe Vullnet Sinaj caktohen anëtarë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

V. Deputetët Alket Hyseni, Ditmir Bushati dhe Reme Lala caktohen anëtarë në Komisionin për Politikën e Jashtme.

VI. Deputetja Lindita Nikolla caktohet anëtare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe deputeti Fatmir Velaj largohet nga ky komision.

VII. Deputetët Antoneta Dhima dhe Elena Xhina caktohen anëtare në Komisionin për Sigurinë Kombëtare dhe deputeti Vullnet Sinaj largohet nga ky komision.

VIII. Deputetja Klotilda Bushka largohet nga Komisioni për Politikën e Jashtme dhe caktohet anëtare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 21.1.2019